



Om. 4635/Prot  
Dt. 30.12.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 804/1 Prot.

Shkodër, më 30.12.2023

**Lënda:** Mbi Vendimin nr. 87, datë 30.11.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja "a", neni 27, pika 5, neni 54, shkronja "e/1", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007 "Për fondin kullosor", të ndryshuar, neni 17, pika 3 dhe 3/1, neni 18, të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e palujtshme të shtetit", të ligjit nr. 8744, datë 22.01.2001 "Për transferimin e pronave të palujtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, të VKM nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", shtojca 1, pika 8/4, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", trajtoi VKB Vau Dejës nr. 87, datë 28.04.2023 "Për rishqyrtimin e Vendimit nr. 38, datë 28.04.2023 Dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 31.03 ha, e shtrirë në pasuritë nr. 736 dhe 738, ZK 3769, e llojit Kullotë, me afat deri në 10 vjet e ndodhur në fshatin Vig, pronë e Bashkisë Vau Dejës. Me qëllim ndërtim linja tensioni, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike, stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse". Për sa trajtuar, në mbështetje të nenit 192, 195 të Kodit Civil, Prefekti ju autorizon procedimin për pasurinë nr. 736, ndërsa për pasurinë 738 ju autorizon procedimin për procedurat e konkurrimit publik, vetëm pasi të pajiseni me çertifikatën e pronësisë të shoqëruar me kartelen e pasurisë së paluajtshme nga ASHK.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T**



**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK****VENDIM**Nr 87 Datë 30.11.2023

**Rishqyrtim i vendimit nr 38, datë 28.04.2023, "Dhënie pëlqimi në parim, për dhënien në përdorim me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 31.03 ha, e shtrirë në pasuritë nr 736, dhe 738, Zk nr 3769, e llojit "Kullotë", me afat deri 10 vjet, ndodhur në fshatin Vig, pronë e Bashkisë Vau Dejës. "Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linjë të tensionit, aerogeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet, objektet përkatëse etj)".**

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja "e/1" (ndryshuar), neni 55 pika 3, neni 27 pika 5, të ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.02.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", ligji nr 8744 datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar. Në VKM nr 10, dt 07.01.2005, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme, publike shtetërore që transferohen në Komunës Vig Mnelë të Qarkut të Shkodrës", Udhëzimin nr 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", VKM nr 559, dt 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", si dhe pas shqyrtimit të Projekt Vendimit Nr 20, dt 21.11.2023, paraqitur nga Drejtoria Juridike Prokurimeve Integritetit dhe Aseteve, ku propozohet rishikimi i Vendimit nr 38, datë 28.04.2023, pas shqyrtimit, diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave, Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI :**

1. Miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes së përgjithshme prej 31.03 ha, e llojit Livadh (Kullotë), e shtrirë në dy numra pasurie, përkatësisht sipërfaqja prej 3.3 ha, pjesë e pasurisë nr 736, dhe sipërfaqja prej 27.73 ha pjesë e pasurisë nr 738, ndodhur në Zk nr 3769, fshati Vig, Bashkia Vau Dejës."Për ndërtim parku fotovoltaike, (stacionet, bazamentet, objektet përkatëse, etj). Plotësimin e dokumentacionit me çertifikatë pronësie për pasurinë nr 736, ku saktësohet lloji i pasurisë Livadh (Kullotë), si dhe në pritje për të marrë çertifikatën e pronësisë për pasurinë nr 738, pas aplikimit të kryer pranë ZVRPP-së Shkodër.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurimeve Integritetit dhe Aseteve.
3. Pas shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut Shkodër, do vazhdohet me shpalljen në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe me procedurat standarte me të gjithë elementët e saj përbërës, sipas Udhëzimit nr 1, datë 09.06.2016, të Ministrit të Mjedisit, "Për rregullat procedurat e kërkimit, të shqyrtimit, e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit kullosor publik, deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes Publike ( sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.)



Kryetari i Këshillit  
Ervis Shimaj

Sekretar i Këshillit  
Ardian Çelepija

Miratuar me 23 vota

Vota pro 23

Vota kundër -

Vota abstenim -

Zbardhur me datë 05.12.2023